



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.19.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË UNIVERSITETIT TË
PRISHTINËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Universitetit të Prishtinës, në konsultim me Ndhimës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Bujar Bajraktari mbështetur nga Shemsije Llugiqi (Udhëheqëse e ekipit), Shefkije Beka, Krenare Pirana dhe Riza Spanca.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	10
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	11
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	28
6 Konkluzioni i përgjithshëm	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	30
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i pasqyrave vjetore financiare (PVF) të Universitetit të Prishtinës (UP) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare është kryer në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë e auditimit ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur deri te një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë fokusohet në:

- Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF);
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në Shtojcën I – Opinionin e Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e pasqyrave financiare.

Opinionin e AP-së është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat vjetore Financiare prezantojnë *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë është jo i plotë. (SNISA 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

Konkluzioni i përgjithshëm

Puna e ndërmarrë nga ana e ZAP për përfundimin e auditimit për vitin 2012 është pasqyrim i drejtëpërdrejt i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti i UP-së. Konkludimi ynë i përgjithshëm është se UP akoma nuk ka arritur rezultate të mjaftueshme në ngritjen e cilësisë së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në përgjithësi.

Ne nuk ishim në gjendje të marrim siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve menaxheriale, duke identifikuar dobësi në shumicën e fushave të menaxhimit financiar. Dobësitë janë të shpjeguara më në detaje në përmbajtjen e këtij raporti.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin UP në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra për vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Përpjekjet në drejtim të implementimit të plotë të tyre duhet të shtohen. Mos adresimi i tyre ka ndikuar që dobësitë e njëjta të menaxhimit dhe raportimit të përsëritën edhe këtë vit.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të UP-së dhe të gjeturat tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore për Rektorin e UP-së janë që:

Pasqyrat vjetore financiare

- Të siguroj që në PVF-të e ardhshme të bëhen shpallje të sakta konform kërkesave aktuale për raportim, duke përfshi vlerën e pasurive dhe të detyrimeve kontigjente.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Të siguroj menaxhim më të mirë të buxhetit në përgjithësi, ndërsa vëmendje e veçant ti kushtohet investimeve kapitale;
- Të ngritet vetëdija në kuadër të stafit që është i kyqur në proceset e prokurimit në lidhje me kërkesat aktuale të legjislacionit të aplikueshëm, dhe të përmirësohet menaxhimi i blerjeve në përgjithësi;
- Të aplikohen kontrolle monitoruese mbi procesin e mbajtjes së ligjeratave dhe kompenzimit të pagave dhe meditjeve në mënyrë që të mos bëhen pagesa për shërbime që nuk janë kryer; dhe
- Të mbikqyret funksionimi i softuerit për menaxhimin e të hyrave në mënyrë që të sigurohet raportim i saktë dhe me kohë.

Sistemi i auditimit të brendshëm

- Në aktivitetet e auditimit të brendshëm të përfshihen të gjitha fushat me rrezik të theksuar, përfshirë shpenzimet për paga dhe meditje; dhe
- Të implementohen rekomandimet e AB, dhe Komiteti i Auditimit të ofrojë përkrahjen e duhur për NjAB dhe për menaxhmentin e UP-së.

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e UP-së të përgatis pasqyrat financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për UP. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjeturave të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat deri në masën që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikave në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkludojmë se pasqyrat financiare të UP-së janë përgatitur në pajtim me kërkesat e SNKSP dhe rregullës financiare 07/2011. Poashtu është përdorur formati standard i raportimit.

Përshkrimi

Pasqyrat vjetore duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh kërkesat e RrF Nr 07/2011, dhe LMFP-së nr 03/L-048.

Bazuar në kërkesat e dokumenteve të lartëpërmendura ne kemi identifikuar se:

- UP ka përgatitur PVF-të konform kërkesave për raportim;
- PVF-të janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Pasqyrat Vjetore Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- Pasqyrat Vjetore Financiare janë dorëzuar në gjuhën shqipe dhe serbe; dhe
- Informatat për pasuritë fikse, për të pagueshmet dhe detyrimet kontingjente janë shpalosur.

Çështjet e ngritura gjatë auditimit të ndërmjetmë, në lidhje me shënimet e pasqyrave financiare, të paraqitura në memon e auditimit të muajit dhjetor 2012, janë adresuar nga Menaxhmenti i UP-së.

Të gjeturat dhe rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Informatat e paraqitura në PVF ishin të një cilësie të pranueshme. Versioni i parë i pasqyrave kishte disa mangësi të cilat pas këshillave tona janë korigjuar nga ana e menaxhmentit të UP-së.

Përshkrimi

Pasqyrat financiare, gjatë procesit të auditimit, për shkak të disa mangësive të vogla janë korigjuar dhe dërguar në thesar. Këto mangësi kishin të bëjnë me disa informata në tabelën e pranimeve dhe pagesave si dhe me shpalosjen e pasurive. Informatat në tabelën e pranimeve janë korigjuar, ndërsa vlera e pasurive me vlerë nën 1,000€ edhe pas korigjimit nuk ishte e saktë.

Ne nuk konsiderojmë se rregullimet e bëra në draft pasqyrat financiare tregojnë dobësi të konsiderueshme në kontabilitet të cilat duhet të raportohen në UP. Megjithatë informatat në lidhje me pasuritë në të ardhmen duhet të shpalosen saktë në PVF. Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF kur pasqyrat janë dorëzuar në MF nuk ka dhënë një vlerësim të saktë cilësisë së PVF-ve.

Të gjeturat dhe rekomandimet

1. Çështja - Procesi i prodhimit të Pasqyrave Financiare- Prioriteti - Të tjera

E gjetura Pasqyrat Vjetore Financiare nuk janë rishikuar nga menaxhmenti para se ato të dorëzohen tek ZAP. Kjo ka rezultuar me shpalosje jo të saktë të pasurive jo kapitale në PVF.

Rreziku Mungesa e rishikimit të pasqyrave nga ana e menaxhmentit mund të ndikoj që ato të mos paraqesin saktë gjendjen financiare. Si rrjedhojë besueshmëria e deklaratës për prezantimin e PVF-ve mund të vihet në dyshim. Mos shpalosja e saktë e vlerës së pasurive në PVF i bën ato jo të besueshme për lexuesit. Njëkohësisht kjo mund t'i shkaktoj menaxhmentit vështirësi në marrjen e vendimeve për investimet eventuale në këtë kategori.

Rekomandimi 1 Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj se do të bëhet rishikimi i PVF-ve të ardhshme, para se ato të dorëzohen në ZAP dhe MF për tu siguruar që janë paraqitur saktë të gjitha informatat dhe shpalosjet.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *panje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë është jo i plotë. Kjo sipas SNKSP nuk ndikon në asnjërën nga dy pasqyrat kryesore financiare (**SNISA 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes***).

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkludojmë se menaxhmenti është pajtuar me nevojën e adresimit të rekomandimeve të AP. Megjithatë ndryshimet e menaxhmentit dhe miratimi i vonshëm i Planit të veprimit kanë penguar në ndërmarrjen e veprimeve me kohë. Ne jemi të vetëdijshëm se adresimi i rekomandimeve kërkon kohë. Por në të njëjtën kohë shprehim shqetësimin tonë për dinamikën e implementimit dhe mënyrën aktuale të trajtimit të rekomandimeve.

Përshkrimi

Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të vitit 2011 janë dhënë 10 (dhjetë) rekomandime kryesore. UP kishte aprovuar një plan veprimi për adresimin e rekomandimeve. Ky plan ishte aprovuar në tetor 2012. Prej këtyre rekomandimeve, një është adresuar plotësisht, dy pjesërisht, ndërsa rekomandimet tjera gjithsej 7 (shtatë) nuk kanë arritur të adresohen. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih shtojcën II.

Të gjeturat dhe rekomandimet

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak-Prioriteti-I rëndësishëm

E gjetura	Rekomandimet nga viti i kaluar nuk janë adresuar plotësisht.
Rreziku	Mos adresimi i plotë i rekomandimeve ka shkaktuar dështime të vazhueshme të kontroleve të brendshme në fushat kyçe të menaxhimit financiar si: menaxhimi shpenzimeve përmes prokurimit, shpenzimet për paga e mëditje, të hyrat etj.
Rekomandimi 2	Rekomandojmë Rektorin e UP-së, të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Gjatë auditimit ne kemi marrë në konsideratë kërkesat e MFK-së. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, mirëpo të njëjtat nuk janë zbatuar siç është planifikuar dhe nuk funksionojnë në mënyrë efektive.

4.2 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkludojmë se menaxhmenti duhet të bëjë analiza më të hollësishme me rastin e përgatitjes së kërkesave buxhetore duke marrë parasysh nevojat e UP-së dhe njësive të saj. Poashtu duhet të mirren paraqysh edhe faktorët e jashtëm ndikues, sidomos kur është fjala për investime kapitale. Sa i përket realizimit të buxhetit konkludojmë se UP përveç kategorisë së investimeve kapitale, që nuk është realizuar, realizuar sipas planit, edhe tek kategoritë tjera ekonomike ka vend për përmirësim të mëtejshëm. Dinamika e realizimit të buxhetit do të duhej të përcillet me analiza periodike në mënyrë që të jetë në harmoni me planin e keshit të përgatitur paraprakisht.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për UP, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Burimet e Fondeve	Buxheti fillestar	Buxheti final SIMFK	Realizimi 2012 i buxhetit	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Totali:	27,192,358	26,849,463	25,113,788	24,576,014	23,690,772
Granti i Qeverisë-Buxheti	17,567,216	16,058,883	15,225,694	14,968,341	15,016,737
Të bartura nga viti paraprak ¹ -	-	460,501	453,478	689,,354	-
Të hyrat vetanake ²	9,625,142	9,437,830	8,951,376	8,475,287	8,443,643
Donacionet Vendore	-	16,000	9,465	3,500	-
Donacionet e Jashtme	-	876,249	473,774	439,532	230,392

Në tabelën 1 është paraqitur buxheti fillestar dhe ai final si dhe burimet e fondeve buxhetore. Në total, buxheti final ishte për 342,896€ më i ulët se sa buxheti fillestar. Diferenca ka të bëjë me ndryshimet që janë bërë gjatë vitit, dhe me përfshirjen e donacioneve dhe të hyrave të bartura nga viti i kaluar në buxhetin e UP-së.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Kategoritë ekonomie	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shuma totale:	27,192,358	26,849,463	25,113,788	24,576,014	23,690,772
Pagat dhe Mëditjet	18,401,148	18,645,111	18,281,648	17,796,469	17,357,598
Mallrat dhe Shërbimet	3,130,862	4,253,608	3,593,185	3,543,985	3,270,797
Komunalitë	1,145,421	1,033,879	930,500	1,048,754	999,253
Subvencionet dhe Transferet	1,314,927	1,426,725	1,236,970	1,028,864	900,149
Investimet Kapitale	3,200,000	1,490,139	1,071,485	1,156,942	1,162,975

Në tabelën 2 janë paraqitur buxheti fillestar, ai final dhe shpenzimet sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve.

¹ Të hyrat vetanake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

² Një pjesë e faturave të planifikuara dhe të mbledhura për Buxhetin e Kosovës në vitin aktual që është përdorur nga entiteti për financimin e buxhetit të vet

Siç shihet edhe nga tabela gjatë vitit kishte lëvizje buxhetore nëpër kategoritë e shpenzimeve. Në bazë të vendimeve të Qeverisë gjatë vitit ishte zvogëluar granti qeveritar për 1,508,333€, prej të cilave 1,389,861€ vetëm nga investimet kapitale³.

Ndërkohë pas ridestinineve të mjeteve kishte lëvizje buxhetore edhe tek kategoritë tjera, ngase me vendime të këshillit drejtues të UP-së gjatë vitit ishin ridestinuuar mjete në vlerë prej 484,542€⁴.

Sa i përket realizimit të buxhetit, në raport me buxhetin final UP ka shpenzuar 25,113,788€ apo 94% nga buxheti final. Realizim më i ulët i buxhetit vërehet tek investimet kapitale, ku në raport me buxhetin final është shpenzuar vetëm 72%, edhe pse ky buxhet gjatë vitit ishte përgjysmuar. As dinamika e shpenzimit nuk ishte sipas planit pasi afërsisht 36% e mjeteve nga kjo kategori janë shpenzuar vetëm në dhjetor. Për mallra dhe shërbime ishte shpenzuar 84% e buxhetit final.

Të gjeturat dhe rekomandimet

3. Çështja - Realizimi i ulët i buxhetit për investimet kapitale–Prioriteti-I rëndësishëm

E gjetura Realizimi i buxhetit për projekte kapitale nuk ishte bërë në pajtim me planifikimet dhe buxhetin. Kjo ka shkaktuar shkurtimin e buxhetit të UP-së nga kjo kategori, nga 3,200,000€ sa ishte në fillim në 1,490,139€⁵

Rreziku Mos arritja e realizimit të investimeve kapitale ul efektivitetin e UP-së veqanërisht në fushën e menaxhimit financiar. Kjo njëherit shkaktonte vonesa në ndërtimin e objekteve dhe lokacioneve që do të mundësonin punë më të efektshme edhe në sferën e arsimit.

Rekomandimi 3 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të sigurojë që hartimi i kërkesave buxhetore të bëhet konform nevojave reale dhe mundësive që i njëjti të realizohet. Të shtohet fokusi tek realizimi i projekteve kapitale në menyrë që praktikatat e deritashme të mos përsëriten. Për këtë duhet të merren parasysh edhe faktorët e jashtëm ndikues.

³ Shkurtime buxhetore janë bërë nga këto projekte: "Laboratori për Univerzitetin e Prishtinës" në vlerë 119,381€, "Ndërtimi dhe Projektimi i dy fakulteteve në Mitrovicë" në vlerë 900,000€, projekti "Ndërtimi i fakultetit të Bujqësisë" në vlerë 70,400€, projekti "Ndërtimi I Amfiteatrit të Fakultetit Ekonomik" në vlerë 250,000€, dhe "Objekti i Dekanatit të Fakultetit të Mjeksisë" në vlerë 50,000€.

⁴ Ridestinineve janë bërë: nga projekti "Ndërtimi i dekanatit të Fakultetit të Mjeksisë" në kategorinë mallra dhe shërbime shuma prej 100,000€, nga projekti "Ndërtimi i objektit të fakultetit të bujqësisë" 220,000€ në kategorinë mallra dhe shërbime, dhe 50,000€ në projektin "Mjete konkretizimi" nga kategoria e shpenzimeve komunale janë ridestinuuar 114,542€ në kategorinë mallra dhe shërbime.

⁵ Pjesa prej 1,389,861€ ishte shkurtim i buxhetit me vendim të Qeverisë, ndërsa pjesa tjetër prej 320,000€ janë ridestinuuar me vendime të këshillit drejtues të UP-së.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

UP gjatë vitit 2012 kishte arritur ti përmbush shumicën e kërkesave aktuale të raportimit të jashtëm.

Përshkrim

Përveq përgatitjes së pasqyrave financiare, UP ka përmbushur në afatin e paraparë ligjor edhe kërkesat e mëposhtme për raportim të jashtëm:

- Kërkesat Buxhetore;
- Plani i prokurimit;
- Raportin financiar nëntëmujor;
- Raportin mbi borxhet, si dhe detyrimet kontingjente janë shpalosur në PVF dhe janë dorëzuar në MF; dhe
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit;

Megjithatë UP ka dështuar të siguroj me kohë:

- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna për vitin 2011; dhe
- Raportet tremujore për shpenzimet.

Të gjeturat dhe rekomandimet

4. Çështja - Mos plotësimi i kërkesave të raportimit të jashtëm - Prioriteti - Të tjera

E gjetura Nuk janë përgatitur dhe dorëzuar në MF raportet tremujore për shpenzimet. Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të AP ishte përgatitur pas afatit të paraparë ligjor.

Rreziku Mos përgatitja e raporteve të rregullta të shpenzimeve, përveq që është në kundërshtim me normat ligjore, menaxhmentit i pamundëson përcjelljen e aktiviteteve e shpenzimeve dhe krahasimin e tyre me planin. Mos përgatitja me kohë e planit të veprimit shkakton vonesa në adresimin e rekomandimeve dhe si rezultat vjen deri te përseritja e mangësive të evidentuara.

Rekomandimi 4 Rekomandojmë Rektoren e UP-së që të ndërmerr masat e duhura për forcimin e kontrolleve buxhetore, duke siguruar që të përgatiten raporte të rregullta për shpenzimet, dhe njëkohësisht të përmbushen edhe kërkesat tjera të raportimit të jashtëm.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se UP akoma nuk ka arritur të vendos kontrolle të mirëfillta në lidhje me raportimin e të hyrave. Gjatë vitit nuk kishte raportime të rregullta nga të gjitha njësitë akademike dhe mungonin harmonizimet mujore dhe ato vjetore në mes të njësive akademike dhe administratës qendrore të UP-së. Njësitë akademike nuk mbajnë evidenca adekuate për të hyrat.

Përshkrimi

UP realizon të hyra nga participimet e studentëve për shkollim sipas tarifave të parapara, kërkime shkencore, punë artistike dhe konsulta, si dhe të hyrat e tjera në përputhje me rregullat e parapara. Për vitin 2012 UP kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 9,625,142€, ndërsa kishte mbledhur gjithsej 9,437,880€. Poashtu UP kishte të hyra të bartura nga viti 2011 në vlerë 460,501€. Nga mjetet e grumbulluara ishin shpenzuar 8,951,376€, ndërsa nga të hyrat e bartura 453,478€.

Konform rekomandimit tonë nga viti i kaluar UP është pajisur me një softuer për regjistrimin e të hyrave. Ky softuer është futur në funksion pjesërisht në vitin 2013. Ne presim që i njëjti të ndihmoj përmirësimin e procesit të raportimit dhe harmonizimit të të hyrave.

Të gjeturat dhe rekomandimet

5. Çështja - Raportime dhe harmonizim jo adekuat i të hyrave-Prioriteti- I rëndësishëm

E gjetura Jo të gjitha njësitë akademike kanë raportuar në baza mujore të hyrat vetanake në administratën qendrore të UP-së, ndërsa Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), për të hyrat "tjera" të realizuara në vlerë 18,500€ nuk kishte raportuar fare gjatë vitit 2012.

Në raportin e barazimit të shënimeve në mes të SIMFK dhe librave të OB për periudhën janar-dhjetor 2012 nuk është paraqitur shuma e raporteve të brendshme, mirëpo është marrë shuma nga SIMFK dhe barazimi është bërë vetëm formalisht. Diferenca në mes të evidencave të UP-së dhe atyre në SIMFK ishte 70,409€.

Rreziku Mos raportimi dhe mos harmonizimet me kohë, mujore dhe vjetore i pamundëson menaxhmentit të UP që të ketë informata të sakta dhe me kohë, për të hyrat e realizuara.

Rekomandimi 5 Rekomandojmë Rektoren e UP-së që të krijojë mekanizma adekuat që sigurojnë evidenca të sakta dhe raportime të rregullta mujore nga të gjitha njësitë akademike. Të bëhet harmonizimi mujor i shënimeve të brendshme me ato të bankës dhe të thesarit. Theks i veçant duhet ti kushtohet aplikimit të softuerit për menaxhimin e të hyrave në menyre që të identifikohen dhe shmangen dobësitë eventuale të tij.

6. Çështja - Mungesa e evidencave për të hyrat e realizuara dhe evidentimi nga personat jo kompetent- Prioritet - Të tjera

E gjetura Në Fakultetin e mjekësisë, regjistrimet e të hyrave e bënë personi i cili nuk është përgjegjës për regjistrimin e të hyrave. Kjo është në kundërshtim me dispozitat e brendshme rregullative të UP-së.

Për mostrat e përzgjedhura për testim nga Fakulteti i Edukimit dega e Prizrenit, nuk na janë ofruar dëshmitë mbështetëse.

Rreziku Regjistrimi i të hyrave nga zyrtarë jo kompetent, mungesa e dëshmive, të pagesave të studentëve, paraqet mangësi të kontroleve të brendshme në fushën e të hyrave, dhe ndarje jo të drejtë të përgjegjësi në procesin pranimit dhe evidencimin të të hyrave.

Rekomandimi 6 Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj që do të forcohen kontrollet mbi procesin e evidentimit dhe raportimit të të hyrave, dhe ndarja e përgjegjësi të bëhet konform dispozitave të brendshme rregullative të UP-së.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Konkludojmë se kontrollet e brendshme që kanë të bëjnë me procedimin e shpenzimeve në kuadër të UP-së kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Testimet tona kanë vënë në pah mangësi në proceset individuale të prokurimit. Pagesat e pagave dhe mëditjeve jo çdo herë janë shoqëruar me dëshmi të mjaftueshme për kryerjen e shërbimeve. Kishte edhe çështje tjera të cilat janë paraqitur më poshtë.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrim

Në këtë kapitull ne kemi mbuluar prokurimet që kanë të bëjnë me Investime kapitale si dhe ato që kanë të bëjnë me mallra dhe shërbime. UP kishte përgatitur planin e prokurimit konform kërkesave. Me këtë plan UP kishte planifikuar zhvillimin e procedurave dhe nënshkrimin e kontratave në vlerë prej 4,600,750€. Regjistri i kontratave të nënshkruara tregon se UP ka arritur të zhvillojë procedura dhe të nënshkruaj kontrata në vlerë prej 2,043,267€, apo shprehur në përqindje rreth 44% të planit.

Ne kemi testuar procedurat e prokurimit, dhe pagesa që ndërlidhen me to duke përfshi investimet kapitale dhe mallrat e shërbimet. Testimet e bëra, kanë vënë në pah mangësitë në vijim:

Të gjeturat dhe rekomandimet

7. Çështja - Mangësi gjatë realizimit të projektit kapital - Prioritet - I rëndësishëm

E gjetura Projekti “Ndërtimi i Amfiteatrit të Fakultetit Ekonomik” ishte përcjellur me parregullsi që nga fillimi i procedurave të prokurimit e deri tek realizimi i tij dhe atë:

Në dosjen e tenderit (paramasa dhe parallogaria) nuk ishin specifikuar sasitë e disa artikujve (pozicioneve) të kërkuara.

Në ofertën origjinale të njërit ofertues që ishte shpallur i papërgjegjshëm (kishte ofertuar çmimin më të lirë se fituesi për rreth 27,000€) kishte ndërhyrje të dyshimtë në përmbajtje. Përmbajtja e originalit nuk ishte e njëjtë me kopjen e ofertës. Këtë e kemi verifikuar pas hapjes së kopjes së ofertës në praninë e menaxherit të prokurimit. Kjo ndërhyrje ka ndikuar në rezultatin e prokurimit.

Gjatë implementimit të kontratës, OE kishte kryer punë që nuk ishin paraparë me kontratë, në vlerë prej rreth 97,890€ për pozicionin e armaturës i cili nuk ka qenë i specifikuar në sasi në dosjen e tenderit, si dhe punë tjera shtesë në vlerë prej 11,568€. Dëshmitë rreth aprovimit të punëve shtesë janë të mangëta derisa arsyetimi i tyre lë vend për analizë.

Menaxhmenti i UP-së kishte formuar një komision për verifikimin e procesit, që nga plani ideor e deri tek implementimi i kontratës. Mirëpo përveq konstatimit të gjendjes ky komision nuk ka dhënë ndonjë rekomandim që do të ndihmonte menaxhmentin në hapat e mëtutjeshëm.

Rreziku Mos specifikimi i sasive të artikujve në paramasë ka vështirësuar përgatitjen e ofertave si dhe vlerësimin e tyre. Kryerja e punëve jashtë kontratës shkakton kosto të paplanifikuara për projektet dhe mund ta vë në vështirësi buxhetore UP-në.

Rekomandimi 7 Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj që dosjet e tenderit do të përmbajnë specifikacione teknike dhe kritere të formuluar në mënyrë specifike, të qarta dhe të matshme si dhe vlerësimi i ofertave të bëhet konform tyre. Punët shtesë paraprakisht të aprovohen nga autoritetet relevante.

8. Çështja - Ndarje e furnizimeve për t'iu ikur procedurave të hapura të prokurimit- Prioriteti- I Rëndësishëm

E gjetura UP kishte zhvilluar gjatë vitit procedura të shumta për furnizimet e njëjta duke praktikuar kuotimin e çmimeve⁶.

Përveq kësaj brenda ditës së njëjtë, OE i njëjtë është shpërblyer me dy kontrata për "furnizim me material për zgjedhjet studentore". Vlerat këtyre dy kontravave ishin 9,500€, respektivisht 9,500.50€.

Rreziku Blerjet e shpeshta me anë të procedurave të kufizuara dhe shmangia e procedurave të hapura të prokurimit mund të shkaktojnë furnizime me çmime më të larta, dhe si rezultat i kësaj edhe shpenzime të panevojshme.

⁶ Për furnizim me "Materiale promovuese" gjatë vitit ishin nënshkruar 5 kontrata me vlerë të përbashkët prej 36,190€; Për furnizim me inventar dhe mobile të ndryshme, ishin nënshkruar 10 kontrata të ndryshme me vlerë të përbashkët prej 67,096€; për furnizim me pajisje të IT-së, përveç dy procedurave të hapura, ishin bërë edhe 9 blerje tjera me kuotim çmimesh. Vlera e këtyre blerjeve ishte 167,071€; Për furnizim me fotokopje ishin zhvilluar 4 kuotime çmimesh me vlerë të përbashkët prej 33,690€. Kishte edhe raste tjera të ngjajshme

Rekomandimi 8 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të siguroj që të aplikohen procedura efektive të prokurimit bazuar në vlerësimin real të kërkesave të UP-së. Për rastet e lartëcekura të grumbullohen kërkesat e njëjësive për furnizime të njëjta në mënyrë që të përdorën procedurat e hapura te prokurimit për produktet e konsumit të përbashkët. Kjo do të ndikonte në efikasitetin e prokurimit si dhe në blerje me çmime më të lira.

9. Çështja - Anulim i panevojshëm i tenderit- Prioriteti- I rëndësishëm

E gjetura Tek procesi i prokurimit për “Ndërtimin e konstruksionit metalik të teatrit në Fakultetin e Arteve” me vlerë 92,961€, nga 9 ofertues, vetëm një ishte vlerësuar si i përgjegjshëm, edhe pse edhe dy ofertues tjerë kishin plotëuar kërkesat të dosjes së tenderit. Raporti i vlerësimit nuk ishte nënshkruar nga kryetari i komisionit, as nga zyrtari i prokurimit. UP-ja ka anuluar tenderin, me arsyetimin se ishte vetëm një ofertë e përgjegjshme. Pas njoftimit, njëri nga ofertuesit është ankuar, lënda është kthyer në rivlerësim, dhe pastaj është nxjerrë fituesi pasi që realisht kishin qenë dhe 2 ofertues tjerë të përgjegjshëm.

Rreziku Anulimi i panevojshëm i tenderit ka shkaktuar vonesa në realizimin e projektit në fjalë dhe rrjedhimisht edhe vonesa në realizimin e buxhetit.

Rekomandimi 9 Rekomandojmë Rektorin e UP-së që në komisionet vlerësuese të caktoj persona me kompetencë në fushën e prokurimit, dhe vlerësimet e tenderëve të mbikëqyren nga menaxheri i prokurimit.

10. Çështja - Mos penalizmi i OE për ndërprerje të kontratës para afatit të kontraktuar - prioritet - Të tjera

E gjetura Kontrata për furnizim me naftë dhe derivate të naftës e lidhur më datë 29.04.2011, ishte shkëputur në muajin nëntor 2011 pasi që OE kishte refuzuar ta realizojë kontratën respektivisht ta furnizoj UP-në me naftë dhe derivate të naftës. Penalet në këtë rast nuk janë aplikuar.

Rreziku Shkëputja e njëanshme e kontratës i ka shkaktuar UP-së mungesë të furnizimeve me derivate dhe e ka detyruar që të gjej zgjidhje alternative emergjente duke ditur që procedurat për këtë furnizim marrin kohë të konsiderueshme.

Rekomandimi 10 Rekomandojmë Rektorin e UP-së që të siguroj që në rastet e dështimit të përmbushjes së kontratave të aplikohen panalet, duke konsideruar edhe konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit. Poashtu duhet të merren masat adekuate, që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen.

11. Çështja - Çmime jo normalisht të ulëta - Prioriteti- I rëndësishëm

E gjetura Në kontratën për “furnizim me material shpenzues” disa nga çmimet e ofertuara, sipas mendimit tonë ishin jonormalisht të ulëta. Psh letër A4 ishte me çmim 0.08€, kalkulator 0.01€ etj. OE kishte ofruar sigurinë e ekzekutimit dhe kontrata ishte nënshkruar me datë 07.06.2012. Konform kësaj kontrate UP ishte furnizuar me material shpenzues deri me 17.07.2012. Vlera e furnizimeve gjatë kësaj periudhe ishte 27,614€.

Në momentin kur UP kishte bërë kërkesë për furnizim me njërin nga artikujt e kontraktuar, respektivisht letër A4 sipas çmimit të ofertuar, OE kishte refuzuar të furnizojë, duke aluduar se nuk e ka kuptuar specifikimin në kohën kur ka ofertuar.

Rreziku Nënshkrimi i kontratave me çmime të tilla krijon mundësi të keqkuptimeve ndërmjet blerësit dhe shitësit. Njëherit refuzimi i OE për furnizim, ka rrezikuar zhvillimin normal të aktiviteteve të UP-së dhe njërive akademike, duke marrë parasysh faktin se në mungesë të depoz UP nuk kishte mbajtur rezerva të materialit shpenzues.

Rekomandimi 11 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të siguroj që hartimi i specifikave teknike do të bëhet deri në detajet më të vogla duke pamundësuar që të ndodhin keqkuptime në lidhje llojet e furnizimeve. Për mospërmbushje të kushteve kontraktuale nga ana e OE të veprohet konform kërkesave ligjore.

4.5.2 Blerjet tjera

Përshkrim

Në këtë kategori janë përfshirë blerjet dhe shpenzimet për të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Nga kjo kategori kemi testuar procedurat dhe pajtueshmërinë e pagesave me dispozitat e aplikueshme ligjore. Testimet tona nuk kanë treguar dobësi materiale, përveq disa mangësive të vogla që janë paraqitur më poshtë:

Të gjeturat dhe rekomandimet

12. Çështja - Shpenzime të karburanteve dhe telefonisë fikse përtej limiteve - Prioriteti - Të tjera

E gjetura Limitet e shpenzimit të karburanteve, të përcaktuara me vendimin për shfrytëzimin e automjeteve, në dy raste janë tejkaluar. Në fakultetin e Xehtarisë dhe Metalurgjisë për muajin maj dhe qershor limiti për shfrytëzim ishte 600 litra të karburanteve, kalkulimet tona kanë vërtetuar se janë shpenzuar 1,283 litra apo 683 litra më shumë.

Veturat e shfrytëzuara nga Rektorati (gjithsej 4 vetura) nuk kanë ndonjë evidencë rreth shfrytëzimit të automjeteve zyrtare duke përfshirë kilometrat, shpenzimet dhe destinacionet.

Poashtu testimi i raporteve të shpenzimeve telefonisë fikse për muajin janar dhe tetor ka treguar tejkalim nga limitet të përcaktuara me rregullore të brendshme të UP-së në vlerë 496€.

Rreziku Mungesa e kontrollit të vazhdueshëm mbi menaxhimin e veturave zyrtare, dhe shpenzimeve operative mund të krijoj shpenzime të panevojshme, si dhe shfrytëzim të automjeteve për qëllime tjera nga ato zyrtare.

Rekomandimi 12 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të siguroj se do të monitorohet në baza të rregullta respektimi i limiteve të përcaktuara të shpenzimeve të karburanteve dhe telefonisë fikse. Në rast të tejkalimeve teprica të rimbursohet. Për shfrytëzimin e automjeteve të plotësohen dokumentet standarde konform kërkesave për menaxhimin e automjeteve zyrtare.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes sistemit të centralizuar të payrollit. Kontrollat që operojnë në kuadër të UP-së kanë të bëjnë me përgatitjen dhe aprovimin e listave të pagave, orëve të mbajtura nga ligjëruesit dhe punëve shtesë që kryhen nga stafi. Universiteti i Prishtinës për vitin 2012 për kategorinë e pagave dhe mëditjeve kishte planifikuar një shumë prej 18,645,112€. Shpenzimet nga kjo kategori kanë arritur shumën prej 18,281,648€ apo 98% të buxhetit. Sa i përket burimit të mjeteve të shpenzuara për paga e mëditje, theksojmë faktin se nga granti qeveritar janë shpenzuar 10,090,933€ dhe nga te hyrat vetanake 8,167,885€.

Ne kemi testuar procedurat e pagesave, përputhshmërinë e pagesave me kontratat dhe kërkesat e legjislacionit të aplikueshëm, si dhe vijueshmërinë e mësimdhënësve në ligjerata. Testimet tona kanë rezultuar me disa mangësi që janë paraqitur në vijim.

Të gjeturat dhe rekomandimet

13. Çështja - Mungesë e dëshmimeve për orët e mbajtura - Prioriteti- I rëndësishëm

E gjetura Për mostrat e zgjedhura për testim në Fakultetin Ekonomik me vlerë prej 25,719€, nuk na janë ofruar dëshmi për evidencat e vijueshmërisë së ligjëratave për personelin akademik, për periudhën e semestrit veror 2011/2012, me arsyetimin se përgjegjësi i mbajtjes dhe azhurnimit të evidencave ka asgjësuar dëshmitë burimore. Ky arsyetim është konfirmuar edhe me shkrim nga prodekani i Fakultetit Ekonomik.

Rreziku Mungesa e evidencave ngrit dyshimin për mos mbajtje të orëve sipas normës së paraparë nga mësimdhënësit. Kjo mund të shkaktoj pagesa për punët që nuk janë kryer, dhe është sinjal për mungesë të transparencës dhe menaxhimit efikas të buxhetit të UP-së.

Rekomandimi 13 Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj se të gjitha dokumentet burimore ruhen konform dispozitave të aplikueshme ligjore, dhe të mos bëhen pagesa pa dëshmi relevante që mbështesin plotësimin e normës së kontraktuar.

14. Çështja - Kompenzimi i plotë me gjithë mungesën nga procesi mësimor- Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Në 8 raste⁷ të testuara të ligjëruesve me kontratë të rregullt në vlerë prej 105,488€, kishte mungesa të mësidhënësve në procesin mësimor. Për orët e pa mbajtura nga këta ligjërues, në bazë të rregullores për të ardhura personale të Universitetit të Prishtinës nr.1/126 personeli që ka munguar nga procesi mësimor është dashur të sanksionohet me heqje të pjesshme të pagës 50€ për çdo orë të humbur nga profesorët, dhe 25€ për çdo orë të humbur nga asistentet. Ndalesa që është dashur të ndodhë sipas përlogaritjeve tona është 10,968€.

Shumica e personelit akademik posedojnë kontratë mbi normë dhe kontratë honorarë, që përcakton numrin e orëve shtesë që duhet të realizohen. Nga 25 pagesat individuale⁸ të testuara me vlerë të përbashkët prej 82,995€, kemi vërejtur se janë kompensuar pa dëshmi për plotësimin e orëve mbi normë dhe honorarë vlera prej 11,248€.

Rreziku Procedimi i pagesave për honorarë dhe orë shtesë të cilat nuk janë mbajtur nga mësimdhënësit, shkakton rritje të pa arsyeshme të shpenzimeve nga kjo kategori. Njëherit kjo është shpenzim jo raacional i buxhetit i cili ka ardhur si rezultat i kontrolleve të brendshme joefikase.

Rekomandimi 14 Rekomandojmë Rektoren e UP-së të siguroj që pagesat e pagave dhe honorarëve për personelin akademik të bëhen në bazë të evidencave të vijimsisë në procesin mësimor, duke respektuar rregullorën e të ardhurave personale në UP. Njëherit kontrollet që kanë të bëjnë me aprovimin e këtyre evidencave dhe procesimin e pagave duhet të sigurojnë që të gjitha pagesat janë për shërbimet e kryera konform kontratave.

⁷Mostrat e testuara janë marrë nga: Fakulteti i Edukimit 1rast , Juridikut 1, Mjekësisë 4, Bujqësisë 1, dhe Arkitekturës 1,

⁸ Mostrat e testuara janë marrë nga: Fakulteti i Edukimit 6 raste, Juridiku 2 raste, F i Mjekësisë 1, Bujqësisë 2, Arteve 4, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike 4 dhe tek Programi për Avancimin e Kuadrove për Mësimdhënësit 5 raste në Fakultetin i edukimit dhe 1 rast nga FIEK.

15. Çështja - Kontratat e punës në kundërshtim me rregulloren e aplikueshme për pagat në UP- Prioriteti – I rëndësishëm

E gjetura Në 4 raste në Fakultetin të Arteve janë nënshkruar kontratat e rregullta të punës në kundërshtim me rregulloren e aplikueshme për paga⁹.

Poashtu, Fakulteti i Edukimit, Juridikut, Mjekësisë dhe FIEK, në 10 raste kanë lidhur kontratat e punës me mbi normë dhe honorarë me nga 6 orë në javë. Kjo është në kundërshtim me rregullorën për të ardhura personale në UP nr.1/126 e cila specifikon se personeli akademik i Universitetit në marrëdhënie të rregullt pune në UP mund të mbaj deri 5 orë ne javë.

Rreziku Përpilimi i kontratave me më shumë orë, mund të shkaktoj shpenzime të tepërta dhe të paplanifikuara.

Rekomandimi 15 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të siguroj që kontrollet e brendshme në fushën e kontraktimit të punës mbi normë dhe honorar të sigurojnë që të gjitha kontratat janë në harmoni me rregullorën e pagave në UP.

4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Pjesa më e madhe e mjeteve nga kjo kategori shpenzohën për bursat e studentëve. Kriteret për procedurat dhe ndarjen e bursave janë të përcaktuar sipas rregullave të brendshme. Bëhen edhe subvencionime të tjera me vendime të këshillit drejtues. Buxheti për subvencione dhe transfere ishte 1,426,725€. Nga kjo shumë gjatë vitit ishin shpenzuar 1,236,970€ apo 87% e buxhetit. Testimet tona nuk kanë treguar ndojnë mangësi materiale sa i përket menaxhimit të kësaj kategorie të shpenzimeve, me përjashtim të dobësive të vogla që janë paraqitur më poshtë:

⁹ Rastet e përmendura kanë të bëjnë me: dy profesor asistent dhe një ligjerues të cilët sipas rregullores është dashur të mbajnë nga 10 orë/javë, kanë nënshkruar kontrata me nga 6 orë/javë; dhe një asistent i cili konform rregullores është dashur të mbajë 16 orë/javë ka nënshkruar kontratën me 10 orë/javë.

Të gjeturat dhe rekomandimet

16. Çështja - Pagesa e kontratave mbi vepër nga subvencionet -Prioriteti - Të tjera

E gjetura UP kishte paguar nga kategoria e subvencioneve, shërbimet e realizuara sipas kontratës mbi vepër në këto raste: për zyrtar administrativ për studime themelore në Fakultetin e Veterinarisë shumën 321€, për zyrtarin e angazhuar si laborant i veterinarisë në institutin e fiziologjise patologjike për periudhën janar dhjetor 2012 shumën prej 1,500€, zyrtarit për qështje studentore në fakultetin e mjeksisë 1,284€, asistentes në zyrën e rektorit 384€ për pagë dhe shtesa, angazhimi i këshilltarit me pagë sekondare prej datës 10.2012 deri më 30.09.2016 me pagë bruto 565€.

Rreziku Pagesat e shërbimeve nga subvencionet dhe transferet shkakton mbivlerësim të shenzimeve nga kjo kategori dhe nga ana tjetër nënvlerësim të shpenzimeve për mallra e shërbime. Kjo poashtu shkakton zvoglim të fondeve për subvencionet.

Rekomandimi 16 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të siguroj që statusi i zyrtarëve administrativë me kontratë mbi vepër të rregullohet konform dispozitave ligjore dhe pagesat e tyre të klasifikohen konform planit kontabël.

17. Çështja - Transferimi i mjeteve në llogarinë personale të kryeredaktorit të revistës -Prioriteti- Të tjera

E gjetura Pagesat e studentëve në vlerë 1,010€ dhe 1,275€ për shkrimet e tyre të botuara në revistën "Bota e re" janë transferuar në llogarinë e kryeredaktorit të gazetës, me qëllim që të njëjtat më pas tu shpërndahën studentëve. Nuk kemi marrë dëshmi se këto mjete u janë shpërndara studentëve.

Rreziku Transferi i mjeteve në mënyrën e tillë, krijon mundësi të ekspozimit të parave ndaj keqpërdorimeve eventuale dhe nuk ka ofron siguri që paratë kanë shkuar në destinacionin e duhur.

Rekomandimi 17 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të siguroj që në rastet e subvencionimit të studentëve, mjetet të transferohen drejtpërdrejt në llogaritë bankare të përfituesve.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasurinë

UP në krahasim me vitet e mëhershme ka bërë përparim në drejtim të vendosjes së kontrolleve mbi menaxhimin e pasurisë. Megjithatë këto kontrolle kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Poashtu raportimi për pasuritë me vlerë më të vogël se 1,000€ në PVF nuk ishte i saktë.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Vlera e pasurive kapitale (mbi 1,000€) të paraqitura në PVF ishte 16,062,080€, ndërsa pasurive jo kapitale (nën 1,000€) ishte 2,859,000€. Gjatë ekzaminimit të evidencave të brendshme të pasurive kemi vërejtur se vlera totale e pasurive me vlerë nën 1,000€ ishte 6,161,952€. Në fund të vitit, konform kërkesave ligjore ishte formuar komisioni për regjistrimin e pasurisë, dhe komisioni për inventarizimin e pasurive. Gjatë vitit ishin regjistruar të gjitha pasuritë jo kapitale në sistemin E-pasuria.

Të gjeturat dhe rekomandimet

Rekomandimi në lidhje me shpalosjen e pasurive është dhënë tek kapitulli “Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare”.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

Konkludimi ynë i përgjithshëm është se UP akoma nuk ka arritur të vendos kontrolle adekuate për menaxhim të mirë të borxheve. Menaxhmenti duhet të meret seriozisht me kontestet kontraktuale, duke iu shmangur mundësisë që këto konteste të krijojnë obligime në të ardhmen. Praktikrat e tilla në të kaluarën e afërt e kanë dëmtuar buxhetin e UP-së. Edhe ketë vit rreth 40% të obligimeve të pa paguara për vitin 2012 janë pasojë e kontesteve kontraktuale.

Përshkrim

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2012 ishte 236,396€. Këto obligime barten për pagesë në vitin buxhetor 2013. Arsyet që kanë ndikuar në mos kryerjen e këtyre obligimeve sipas shpjegimeve të zyrtarëve janë: mungesa e mjeteve, pranimi i faturave me vonesë si dhe kontestet kontraktuale.

Poashtu UP ka shpalosur në pasqyra financiare edhe detyrimet kontingjente në vlerë prej 1,881,770€. Këto kanë rrjedhur ndër të tjera si rezultat i kontesteve të ndryshme.

Të gjeturat dhe rekomandimet

18. Çështja - Menaxhimi i borxheve- Prioriteti- I rëndësishëm

E gjetura Vonesat në pagesës e faturave si rezultat i kontesteve kontraktuale kanë shkaktuar obligime të papaguara në fund të vitit.

Rreziku Mos pagesa e faturave me kohë mund të shkaktojë shpenzime shtesë dhe të paplanifikuara për UP në vitin pasues. Kontestet kontraktuale rrezikojnë të kthehen në padi eventuale gyqësore që prap do të shkaktonte kosto eventuale shtesë për UP-në.

Rekomandimi 18 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të forcoj kontrollet në lidhje me menaxhimin e borxheve, dhe të siguroj që pagesat e faturave të bëhen konform afateve ligjore. Gjendja e krijuar me kontestet kontraktuale duhet të shqyrtohet, të përcaktohen shkaktarët dhe të merren masat adekuate për evitimin e tyre në të ardhmen, ngase të njëjtat mund ti krijojnë kosto shtesë UP-së.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Funksionimi aktual i auditimit të brendshëm nuk ofron mbështetje dhe siguri të mjaftueshme për menaxhmentit të UP-së në lidhje me funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme financiare. Një fuqizim i mëtejshëm i kësaj njësie do të duhej të merret në konsideratë nga ana e menaxhmentit të UP-së, në kuptim të shtimit të numrit të Auditorëve. Në planin strategjik dhe atë vjetor të auditimit duhet të përfshihen fushat me rrezik siç janë menaxhimi i shpenzimeve për paga e medijve, subvencionet, borxhet etj.

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në kuadër të UP-së ka vetëm një Auditor. Kjo njësi, gjatë vitit 2012 kishte kryer 5 (pesë) raporte të auditimit¹⁰. Këto raporte ishin të parapara në planin vjetor të auditimit. Në raporte janë ngritur çështjet që kanë nevojë për përmirësim dhe janë dhënë rekomandimet për menaxhmentin. Janë përgatitur planet për implementim të rekomandimeve, mirëpo ne nuk kemi vërejtur se të njëjtat janë adresuar.

Komiteti i auditimit ka mbajtur tri takime, ka nxjerr konkluzione për veprimin e implementimit të rekomandimeve të ZAP-it si dhe ka rishikuar dhe analizuar raportin e punës së NjAB-së.

Të gjeturat dhe rekomandimet

19. Çështja - Auditimi i brendshëm- Prioriteti- I rëndësishëm

E gjetura Shpenzimet e pagave dhe mëditjeve nuk janë përfshirë në aktivitetet e Auditimit të brendshëm. Nuk janë implementuar rekomandimet e dhëna nga NjAB.

Rreziku Shpenzimet për paga e medijve përbëjnë afërsisht 70% të shpenzimeve vjetore të UP-së. Prandaj menaxhmenti ka nevojë që të marrë siguri që kontrollet e brendshme në këtë fushë janë efikase. Këtë siguri do ta ofronte NjAB po të përfshihej kjo në aktivitetet e saj.

Rekomandimi 19 Rekomandojmë Rektorin e UP-së të siguroj që në aktivitetet e NjAB-së, përveq tjerash të përfshihen edhe shpenzimet e pagave, si dhe të implementohen rekomandimet që dalin nga auditimet e brendshme.

¹⁰ Auditimet kanë mbuluar fushat si: Procedurat e menaxhimit të grumbullimit të hyrave në Fakultetin Ekonomik, procedurat e menaxhimit të pasurive dhe inventarit në UP, procedurat e prokurimit, procedurat e menaxhimit të shpenzimeve të automjeteve dhe mirëmbajtja e tyre, dhe të hyrat tjera në Fakultetin e Bujqësisë.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është reflektim i rishikimit të kontrolleve të ndërlidhura me kërkesat e raportimit, Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe Sistemit të Auditimit të Brendshëm.

Sipas mendimit tonë menaxhmenti i UP duhet edhe më tej të zhvilloj sistemet e kontrolleve të brendshme në mënyrë që të sigurohet se transaksionet dhe aktivitetet ndodhin konform synimeve dhe planeve të institucionit dhe se të njëjtat raportohen në harmoni me kërkesat aktuale për raportim.

Çështjet e ngritura brenda këtij raporti duhet të adresohen. Niveli aktual i zbatimit të rekomandimeve të AP nga viti i kaluar nuk përkon me planin e veprimit që kishte hartuar menaxhmenti i UP-së për këtë qëllim. Kompleksiteti dhe shtrirja e veprimtarisë së UP është faktor i cili ndikon që implementimi i proceseve dhe procedurave të nevojshme për menaxhim të marrin kohë të konsiderueshme. Megjithatë kjo nuk duhet të konsiderohet arsye për mosmarrje të menjëhershme të masave për përmirësimin e gjendjes aktuale.

Në të gjitha fushat e shpenzimeve, ku më pak e ku më shumë janë vërejtur mangësi. Zhvillimi i procedurat e prokurimit, dhe menaxhimi i kontratave janë fusha ku nevojitet më shumë vëmendje nga ana e menaxhmentit. Procesi i përlogaritjes dhe procedimit të pagave dhe mëditjeve kërkon shtim të masave të kontrollit. Çështja e raportimit të tehyrave nga njësitë e UP-së mbetet akoma sfiduese.

Zhvillimi i mëtejshëm i auditimit të brendshëm duhet të merret në konsideratë. Poashtu Komiteti i auditimit duhet të sigurohet që i ka dhënë mbështetjen e duhur NjAB-së në kryerjen e detyrave, dhe menaxhmentit në adresimin e rekomandimeve të dala nga auditimet e brendshme.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriktionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhena	Rekomandimet plotesisht te adresuara	Rekomandimet pjeserisht te adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
4. Ekzekutimi i buxhetit në krahasim me ate të realizuar	Planifikimin, monitorimin dhe shfrytëzimin e buxhetit, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët që kanë ndikim në çështjet buxhetore, duke u bazuar në rrjedhën e parasë dhe alokimin e shpenzimeve në baza tremujore; dhe Forcimin e kontrollit në menaxhimin fondeve për investimet kapitale, për të arritur efikasitet më të madh në realizimin e kontratave në afatet e caktuara.			Gjendja është e njëjtë dhe nuk vërehen përmirësime Tek realizimi i investimeve kapitale vazhdon të ketë vështirësi
6.1 Te hyrat	Regjistrimi dhe monitorimi i të hyrave të bëhet përmes zhvillimit të një programi softuerik, ku mundësia e shfaqjes së diferencave do të reduktohej në nivel minimal dhe kontrollet do të jenë më efektive; Të listohen të gjithë kandidatët të cilët kanë bërë pagesa më pak sesa duhej të bënin, dhe të njëjtit t'i	Sipas informatave nga zyrtarët e UP-së listat e	Është blerë softueri për regjistrimin e të hyrave por akoma nuk është funksionalizuar plotësisht.	

	<p>bëjnë pagesat në shuma të plota, ashtu siç është përcaktuar me rregulloret e UP. Kontrolllet e verifikimit të këtyre pagesave, në të ardhmen të jenë të përshtatshme, për të mos u përsëritur praktikat e tilla;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Analizimin e gjendjes së krijuar nga auditimi i brendshëm lidhur me pagesat e studentëve; dhe • Harmonizimet në baza mujore për të hyrat vetjake në mes administratës qendrore dhe të njëjësive akademike, si dhe harmonizimet në mes të AQ-Thesarit dhe BQK. 	kandidatëve që kanë manipuluar me pagesa janë dërguar në prokurori.		Nuk janë bërë harmonizimet mujore të evidencave.
6.2.1 Kompenzimi Paga dhe Meditje	<p>Rishikimin e politikave për paga dhe aplikimin e tyre bazuar në procedura dhe vlera të legjislacionit për shërbyesit civil;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontraktimin me kontrata të rregullta pune mbi bazën juridike; • Rritjen e mbikëqyrjes mbi vijueshmërinë e ligjëratave nga ana e personelit akademik; dhe <p>Kontrollet e raportimit dhe raporte të sakta të mbahen nga secili departament për punët që janë kryer si rezultat i aktiviteteve jashtë orarit të rregullt të punës.</p>			Asnjë masë nuk është marrë në këtë drejtim.

6.2.2. Prokurimi	<p>Forcimin e kontrolleve lidhur zhvillimin e proceseve të prokurimit në përgjithësi, dhe me kontrata të shpërblehen operatorët më konkurrent dhe më të favorshëm;</p> <p>Ekzistojnë fondet e mjaftueshme për realizim te projekteve të kontraktuara;</p> <p>Aplikon penalet sipas kontratave, për mos liferimin e mallrave me kohë ndaj të gjithë OE;</p> <p>Të zhvillojë politika dhe procedura për t'u siguruar që cila do kompani që do të marrë kontratën, të ofrojë sigurimin e ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës; dhe</p> <p>Se të gjitha pagesat bëhen vetëm në pajtim me vlefshmërinë e kontratave.</p>			Duke pasur parasysh që gjendja e procesit të prokurimit vazhdon të përcillet me dobësi të njëjta konkludojmë se nuk janë implementuar rekomandimet në këtë fushë
6.2.3 Blerjet tjera	<p>Kontroll të shtuar lidhur me shpenzimet si në aspektin procedural, po ashtu edhe në atë financiar. Kontrollët duhet shtuar sidomos në rastet kur kërkohet aplikimi i blerjeve përmes prokurimit.</p>			Nuk është vërejtur përmirësim në këtë fushë.
6.2.4. Subvencionet	<p>Hartimin e një Udhëzuesi të brendshëm duke i specifikuar qartë të kushteve dhe kritereve mbi ndarjen e subvencioneve; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Respektimin e memorandumit të nënshkruar me MF. 			Nuk është ndërmarrë ndonjë masë.

6.2.5 Çertifikimi i pagesave, dhe regjistrimi ne kode jo adekuate	<p>Forcimin e kontrolleve mbi çertifikimin e pagesave, në mënyrë që të sigurohet se ekzistojnë të gjitha dëshmitë përkatëse; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rishikimin dhe vlerësimin e procesit të pagesave, në mënyrë që të gjitha pagesat të bëhen sipas kodeve përkatëse të përcaktuara nga Thesari. 			Edhe këtë vit mangësitë e tilla janë përseritur.
6.3 Pasuritë	<p>Rregullimin e çështjeve pronësore me komunitet</p> <p>Regjistrimin e të gjitha pasurive të UP në pajtim me kërkesat e UA nr. 21/2009 mbi menaxhimin e pasurive qeveritare.</p>		Pjesërisht i implementuar, UP ka bërë regjistrimin e pasurisë në pajtim me kërkesat e UA nr. 21/2009 mbi menaxhimin e pasurive. Mirëpo nuk janë zgjedhur çështja pronësore.o.	
6.4 Trajtimi i borxheve	<p>Se detyrimet e papaguara janë regjistruar në regjistrat kontabël dhe janë prezantuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Detyrimet e papaguara duhet të shpalosen, të vlerësohen dhe të buxhetohen për vitin vijues; dhe • Vlerësim në baza të vazhdueshme të gjendjes së detyrimeve të pa paguara, duke i dhënë prioritet pagesave sipas vjetërsisë. 	po		

<p>7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm</p>	<p>Funksionalizimin e NJAB në kuptimin e numrit të mjaftueshëm të auditorëve; dhe</p> <ul style="list-style-type: none"> • Se komiteti i auditimit do të jetë më aktiv dhe do të mbaj takime të rregullta pune për të siguruar mbikëqyrje të duhur të planeve dhe rezultateve të auditimit dhe për të siguruar që rekomandimet e auditimit janë adresuar si duhet. 		<p>Pjesërisht i implementuar. Komiteti i auditimit ka arritur të mbaj tri takime të rregullta pune. Mirëpo rekomandimet e AB nuk janë implementuar.</p>	
---	---	--	---	--